

Manual për gazetarë për
regjistrimin e ardhshëm
në Republikën
e Maqedonisë së Veriut

REGJISTRIMI SI TEMË GAZETARESKE



Botues: Platforma Maqedonase Kundër Varfërisë (MPPS)

www.mpps.org.mk

Autore: d-r Jasna Baçovska Nediq, Profesore e rregullt
në Fakultetin Juridik “Justinijani i Parë” USHCM, Shkup

Lektore: Violeta Risteska

Përktheu në gjuhën shqipe: Marsida Petrofski-Trajko

Disajni dhe hartimi teknik: Muv Dizajn (MOVEdesign)

Hartimi dhe shtypja e këtij botimi është bërë i mundur nga Fondi i Popullatës të Kombeve të Bashkuara (UNFPA) si pjesë e projektit. Forcimi i kapacitetit kombëtar për grumbullimin, analizën, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave të popullatës, për zhvillimin e informuar të politikave identifikuese të pabarazive sociale dhe ekonomike.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ato të autorëve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e UNFPA-së, KB-së ose ndonjë organizate të lidhur me këto institucione .

Kur përdorni të dhënat, ju lutemi citoni burimin: “Regjistrimi si temë gazetareske, Manuali për gazetarë mbi regjistrimin e ardhshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, MPPS, dhjetor 2019.

PËRMBAJTJE

| | |
|---|----|
| GAZETARI ME PËRGJEGJËSI SHOQËRORE NË NDJEKJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË POPULLATËS, FAMILJEVE DHE BANESAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT | 3 |
| PSE DUHET REGJISTRIMI | 5 |
| REGJISTRIMI SI KRITER PËR BE | 9 |
| REGJISTRIMI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM (SDGs- Sustainable Development Goals)..... | 11 |
| ÇFARË ËSHTË REGJISTRIMI? | 13 |
| ÇFARË REGJISTRIMI DO TË ZBATOHET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT | 16 |
| REGJISTRIMI SI TEMË GAZETARIE | 19 |
| PËRKATËSIA ETNIKE SI ÇËSHTJE E REGJISTRIMIT | 21 |
| RREGULLATIVA KOMBËTARE | 23 |
| AGJENCIA KOMBËTARE STATISTIKE: ENTI SHTETËROR I STATISTIKËS (ESHS)..... | 32 |
| Komunikimi strategjik i ESHT-së me publikun gjatë regjistrimit | 33 |
| GAZETARI ME AKSES KONTROLLOR-INVESTIGATIV NË REGJISTRIM | 37 |
| Sa është shpenzuar për regjistrimin? | 42 |
| KIERARKIA E KOMPETENCËS | 43 |
| INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE | |
| PËR REGJISTRIMIN | 47 |
| UN –Roli i Kombeve të Bashkuara | 47 |
| UNSD –Zyra e Statistikave të Kombeve të Bashkuara | 47 |
| UNFPA – Fond për popullatën e Kombeve të Bashkuara | 49 |
| USCB –Byro për regjistrimin e popullatës në SHBA | 50 |
| ICCC –Komiteti i Koordinimit Ndërkombëtar të Regjistrimit | 50 |
| Eurostat | 51 |
| REGJISTRIMI , GAZETARIA PRECISE DHE GAZETARIA QË OFRON ZGJIDHJE (Solution Journalism) | 53 |
| „Solution Journalism“ | 53 |



GAZETARI ME PËRGJEGJËSI SHOQËRORE NË NDJEKJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË POPULLATËS, FAMILJEVE DHE BANESAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Në Republikën e Maqedonisë së Veriutpas Luftës së Dytë Botërore, janë kryer 8 regjistrime në vitet: 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991, 1994 dhe 2002 dhe Regjistrimi i parealizuar , d.m.th. i ndërprerë në vitin 2011. Të gjitha regjistrimet janë zbatuar duke përdorur mënyrën tradicionale të regjistrimit, me rrugën e intervistës nga ana e regjistruarve të trajnuar me formularë anketues për regjistrimin.

Pas 17 vjetësh nga regjistrimi i fundit i mbajtur tek ne, ka ende një konstatim për regjistrimet në vendin tonë, i cili u prezantua në takimin shkencor në ASHAM i cili u mbajt me rastin e regjistrimit të popullsisë të bërë në vitin 2002, përkatësisht:

“Është bërë praktikë e zakonshme që regjistrimet tona, nga një veprim rutinë statistikor të marrin karakterin e ngjarjeve politikisht aktuale. Ato bëhen një preokupim i mediave, partive dhe grupeve politike, i opinionit publik, por edhe si ngjarje që interesojnë dhe intrigojnë opinionin ndërkombëtar (monitorimin). Fenomene të tilla gjenerojnë gjykime të ndryshme jo objektive nëse ato nuk janë më parë rezultat i përpjekjeve kërkimore. Përhapet arbitrazh, tensione ndëretnike, spekulime dhe krijohet konfuzion në sistemin ndërkombëtar të informacionit dhe konceptet e gabuara politike me

paraqitjen e konflikteve në vend”.¹ Se politizohen regjistrimet flet edhe fakti që grupe të caktuara etnike e bojkotojnë Regjistrimin, si për shembull Regjistrimin e popullatës në vitin 1991, ndërsa komuna e Dibrës në vitin 1994. Përmes observimeve gazetareske të regjistrimit si aksioni më masiv statistikor, gazetaria mund të bëhet faktori shoqëror aktiv dhe faktori demografik përmes promovimit të gazetarit/gazetarisë si avokat i grupeve sociale të lëna pas dore, gazetar investigativ, gazetar i cili është lidhja midis shoqërisë civile dhe pushtetit, gazetar – pedagog, gazetar – zbulues dhe një gazetar me gazetari të saktë që i afrohet saktësisë shkencore dhe argumentimit. Në rast të regjistrimit gazetaria duhet të bëhet mbrojtëse e keqpërdorimit të statistikëve nga faktorët politikë, pushteti, me ndjekjen objektive, analitike dhe kritike të procesit.

1 Lëvizje demografike aktuale në Republikën e Maqedonisë nga rezultatet e regjistrimit të popullatës 2002, Kronika nga tubimi shkencor i mbajtur më 2 dhe 3 qershor të vitit 2005, ASHAM, Shkup 2007, fq.18



МАКЕДОНСКА ПЛАТФОРМА ПРОТИВ СИРОМАШТИЈА
MACEDONIAN ANTI-POVERTY PLATFORM



Për Entin Shtetëror të Statistikës si koordinator kombëtar i sistemit statistikor në vend gjithsesi një prej prioriteteve strategjike është një përgatitje në kohë dhe në mënyrë efektive, organizimi dhe zbatimi i Regjistrimit të popullatës, familjeve dhe banesave. Mospasja e të dhënave nga regjistrimi me një datë më të re, për faktin se Regjistrimi në vitin 2011 ishte ndërprerë dhe nuk u realizua, me kalimin e çdo viti ka një ndikim të drejtpërdrejtë në produksionin statistikor të së dhënave.

PSE DUHET REGJISTRIMI

Regjistrimi i popullsisë siguron të dhëna për popullsinë dhe shpërndarjen e saj territoriale, si dhe strukturën demografike, gjeografike, ekonomike dhe sociale. Regjistrimi i familjeve siguron të dhëna për numrin e familjeve dhe shpërndarjen e tyre territoriale, si dhe të dhëna për strukturën e familjeve sipas madhësisë, llojit dhe përbërjes familjare të tyre. Regjistrimi i banesave siguron të dhëna

për numrin e banesave sipas llojit dhe shpërndarjen e tyre territoriale, dhe banesat, për sa i përket ndërtimit, gjithashtu sigurojnë të dhëna për madhësinë e tyre, instalimin dhe ambientet ndihmëse.

Regjistrimi është burimi kryesor për marrjen e të dhënave demografike, gjeografike, arsimore dhe socio-ekonomike për popullsinë e një vendi.

Me Regjistrimin vijues të popullsisë, familjeve dhe banesave do të jepen të dhëna për numrin e përgjithshëm dhe shpërndarjen e territorit të njërive themelore të Regjistrimit (personat, familjet dhe banesat), si dhe të dhëna për karakteristikat dhe tiparet e tyre kryesore dhe do të identifikohen ndryshimet që kanë ndodhur në regjistrim, që nga regjistrimi i fundit i popullsisë, familjeve dhe banesave në vitin 2002.

Prandaj, qëllimi kryesor i Regjistrimit është të përcaktojë numrin e popullsisë dhe shpërndarjen e tij territoriale, të marrë të dhëna për karakteristikat jetike,

etnike, arsimore, ekonomike, migruese dhe karakteristikat e tjera të popullsisë. Regjistrimi është baza për vlerësimin e numrit dhe lëvizjes së popullsisë në periudhën midis regjistrimit, si dhe për parashikimet afatgjata të numrit të popullsisë në të ardhmen.

Meqenëse përveç regjistrimit të popullsisë, njëkohësisht bëhen edhe regjistrimet e familjeve, Regjistrimi synon të sigurojë të dhëna për amviseritë dhe familjet jo vetëm si bashkësi themelore ekonomike (struktura e tyre sipas numrit të anëtarëve, numri i personave aktivë, burimet e të ardhurave), por edhe për komunitetet biologjike dhe për ndryshimet në numrin dhe strukturën e familjeve dhe karakteristikat e tyre kryesore.

Qëllimi i Regjistrimit të banesave është të sigurojë të dhëna mbi strukturën e fondit të banesave, d.m.th. të përcaktojë shfrytëzimin e tyre, sipërfaqen, numrin e dhomave, ambientet e arredimit (kuzhinë,

ambiente sanitare), pajisjet me instalime elektrike, ujësjellës dhe ngrohje qendrore, pastaj vitin e tyre të ndërtimit, katetëj. Regjistrimi gjithashtu duhet të sigurojë të dhëna për banesa të pabanuara, si dhe banesat që përdoren për pushime dhe rekreacion (vila dhe shtëpi familjare). Regjistrimi i vitit të ardhshëm, krahasuar me Regjistrimin e mëparshëm të 2002 dhe 2011, gjithashtu do të mbledhë të dhëna për personat që mungojnë dhe që janë jashtë vendit për më shumë se 1 vit në mënyrë që të marrin të dhëna më relevante për numrin e mërgimtarëve. Regjistrimi i mëposhtëm gjithashtu do të mbledhë të dhëna për personat me aftësi të kufizuara, d.m.th. mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore të njëjste të regjistrimit. Qëllimi i përfshirjes së këtij grupi pyetjesh është të sigurojë të dhëna për numrin e personave me aftësi të kufizuara, të cilët për shkak të statusit të tyre të përgjithshëm shëndetësor,

kanë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve ditore, sipas llojit dhe shpërndarjes së tyre territoriale, dhe të cilat do të shërbejnë si kornizë statistikore për sondazhet e personave me këtë lloj vështirësie.

Pra, Regjistrimi do të sigurojë statistika të plota, cilësore, të azhurnuara dhe ndërkombëtarisht të krahasueshme mbi popullsinë, familjet dhe banesat për të përmbushur nevojat kombëtare dhe ndërkombëtare të përdoruesve.

Regjistrimi (statistika) mund të japë përgjigjen e disa pyetjeve. Nëse papunësia shkon në rritje apo në ulje? Nëse ka emision më të lartë të CO2 në krahasim me 10 vitet paraprake? Sa gra shkojnë në punë? Cilat janë performancat e ekonomisë në vendin Tuaj në krahasim me vendet e tjera anëtare në Bashkimin Evropian?²

Shoqëritë demokratike nuk mund të funksionojnë siç duhet pa një bazë

të fortë të statistikave të besueshme dhe objektive. Regjistrimi garanton një politikë demokratike, të drejtë dhe të qëndrueshme.

Regjistrimi i nevojitet hartuesve të politikave si:

- Sektorit të biznesit: mbi bazën e këtyre të dhënave mund të merren vendime për investime, zhvillim, fuqinë punëtore
- Shtetit (qeverisë) dhe institucioneve të tjera publike: për shembull për krijimin e politikave të popullsisë dhe politikve të tjera sociale.
- Shkencës: të dhënave për investigim, projekte për gjednje të caktuara, punë shkencore etj.
- Qytetarëve: me qëllim që të informohen dhe të marrin vendime edukative d.m.th. për nevojat e pjesëmarrjes informative në aktivitetet publike si dhe ndërtimin e politikës participuese kulturore.

SIPAS PARIMEVE DHE REKOMANDIMEVE TË KB-SË PËR REGJISTRIMET E POPULLSISË DHE STREHIMIT, DISA NGA ROLET THEMELORE TË REGJISTRIMIT JANË:



ADMINISTRATA PUBLIKE:

Rezultatet e regjistrimit përdoren si një referencë kritike për të siguruar barazi në shpërndarjen e pasurisë, shërbimet shtetërore dhe përfaqësimin në nivelin kombëtar: distribuimin dhe shpërndarjen e fondeve qeveritare nëpër rajone dhe fusha të ndryshme të arsimit, shërbimeve shëndetësore, përcaktimin e zonave elektorale në nivel kombëtar dhe nivel lokal, si dhe matja e ndikimit të zhvillimit industrial. Vendosja e një konsensusi publik mbi përparësitë do të ishte pothuajse e pamundur të arrihet nëse nuk ndërtohet në pikat e regjistrimit. Shumë përdorues të tjerë, përfshirë sektorin e korporatave, akademinë, shoqërinë civile dhe individët, përdorin rezultatet e regjistrimit.



KUADËR PËR EKZEMPLARË:

Regjistrimi luan një rol thelbësor në sistemin kombëtar të statistikave. Statistikat e regjistrimit përdoren për përpilimin statistikor ose si kornizë e ekzemplarëve për anketat e ekzemplarëve. Pa një kornizë të ekzemplarëve dhe standardet e popullsisë që dalin nga regjistrimet e popullsisë dhe strehimit, sistemi kombëtar statistikor do të përballet me vështirësi në sigurimin e statistikave zyrtare të besueshme për t'u përdorur nga Qeveria dhe opinioni i gjerë;



VLERËSIMI I ZONËS SË VOGËL:

Një tipar kryesor i regjistrimit është krijimi i statistikave për zonat e vogla dhe grupet e vogla të popullsisë pa gabime / minimale të marrjes së ekzemplarëve. Ndërsa statistikat e zonave të vogla janë të dobishme në mënyrën e tyre, ato janë të rëndësishme sepse ato mund të përdoren për të prodhuar statistika për çdo njësi gjeografike me kufij arbitrare.

PIKA STANDARDE:

Rezultatet e regjistrimit përdoren për investigime dhe analiza. Projektionet e popullsisë janë një nga rezultatet më të rëndësishme analitike bazuar në të dhënat e regjistrimit; Projektionet e ardhshme të popullsisë janë vendimtare për të gjithë segmentet e sektorit publik dhe privat.



Avantazhi i regjistrimit krahasuar me investigimet e tjera statistikore është se përfaqëson tërë universin statistikor në njësinë më të vogël gjeografike të një vendi ose rajoni. “Krijuesit e politikave” kanë nevojë për këtë informacion për të gjitha llojet e aktiviteteve të zhvillimit, përfshirë:

- vlerësimin e trendeve demografike
- analiza të kushteve socio-ekonomike;
- përpilimin e strategjive për uljen e varfërisë të bazuara në argumenta
- ndjekjen dhe vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe
- ndjekjen dhe avancimin e objektivave të dakorduara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Informacionet, gjithashtu, ndihmojnë që të rritet vetëdija për çështje të popullatës midis bartësve qeveritarë të vendimeve dhe opinionit në tërësi. Pra, regjistrimi kombëtar është burimi i vetëm i informacioneve për identifikimin e formave të përjashtimit social, demografik dhe ekonomik, Regjistrimi siguron të dhëna për rajonet të cilëve u janë bërë padrejtësi dhe grupeve të cenueshme si të varfërit, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë dhe vajzat.

REGJISTRIMI SI KRITER PËR BE-NË

Shtetet Anëtare të BE-së janë të detyruara me Kuadrin rregullativ të Parlamentit dhe Këshillit dhe tre Rregulloreve të Komisionit

2017. Në nivel global, 40% e të gjithë treguesve për të matur përparimin drejt 17 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës së vitit 2030³ varen nga të dhënat e regjistrimit.

Metodologjia dhe temat e regjistrimit përcaktohen nga organet ndërkombëtare të statistikave dhe reflektohen edhe në legjislacionin e BE-së. Programi i regjistrimit të popullsisë dhe familjeve i vitit 2020 është i koordinuar nga Komisioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara⁴ dhe Konferenca e Statistikave Evropiane të UNECE⁵. Parimet dhe rekomandimet për vitin 2020 u miratuan që në vitin 2015.

3 https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/generalassembly/docs/globalcompact/A_RES_70_1_E.pdf?fbclid=IwAR1u_iWiEQNdonb7sz8COZfwDF_EKY1ldAd10bdWPslvBMnHLbKwEkYn3Sk

4 <https://unstats.un.org/unsd/statcom/>

5 <https://www.unece.org/info/ece-homepage.html>



REGJISTRIMI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM (SDGs- Sustainable Development Goals)6

Komisioni Botëror për Mjedis dhe Zhvillim (i njohur si Komisioni Brutland⁷) përcakton zhvillimin e qëndrueshëm si: Zhvillim që plotëson nevojat e brezave të tanishëm, pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre. Ky përkufizim nënkupton pikëpamjet e zhvillimit të qëndrueshëm të Republikës së Maqedonisë dhe përmbledh një numër mendimesh dhe vizionesh.

Përkufizimi vijon të thotë: “Në thelb, zhvillimi i qëndrueshëm është një proces ndryshimi në të cilin përdorimi i burimeve, orientimi i investimeve, orientimi i zhvillimit teknik dhe ndryshimi institucional janë në harmoni dhe forcojnë potencialet e tanishme dhe të ardhshme në mënyrë që të përmbushen nevojat dhe aspiratat njerëzore”. Zhvillimi i qëndrueshëm përfshin tre dimensione të ndërvarura dhe të ndërthurura:

- Dimensioi Ekonomik (burimet ekonomike, zhvillimi dhe rritja)
- Dimensioi mjedisor (burimet natyrore, ruajtja e natyrës dhe përdorimi i qëndrueshëm dhe parandalimi dhe kontrolli i ndotjes)
- Dimensioi shoqëror (burimet shoqërore, solidariteti dhe lufta kundër varfërisë)8.

Këto dimensione janë të lidhura me popullatën / popullsinë, më saktë 40% e treguesve të zhvillimit të qëndrueshëm SDG janë të lidhura me popullatën. Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të miratuar nga KB në 2015⁹ paraqesin një sfidë të rëndësishme dhe themelore për komunitetin e zhvillimit global dhe do të formojnë axhendën e zhvillimit global deri në vitin 2030. 17 qëllimet, me 169 qëllimet e tyre të ndërlidhura dhe më shumë se 230 tregues unikë, janë shumë ambiciozë dhe do të kërkojnë shumë përpjekje nga kombet, qeveritë, organizatat civile dhe nga popullata e përgjithshme. Arritja e një zhvillimi të qëndrueshëm deri në vitin 2030 do të kërkojë gjithashtu përparim drejt përmbushjes së objektivave për tu monitoruar në mënyrë

6 <http://unsdsn.org/resources/publications/monitoring-the-sdgs-by-means-of-the-census/>

7 <https://idl-bnc-idrc.dspacedirect.org/handle/10625/53401>

8 STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM PJESA I / II (2009–2030)<http://www.macedfrr.gov.mk/files/dokumenti/NSSD.pdf>

9 <https://www.sustainabledevelopment2015.org/AdvocacyToolkit/index.php/earth-summit-history/past-earth-summits/58-the-brundtland-commission>



të rregullt, e cila nga ana tjetër do të paraqesë sfida të rëndësishme të të dhënave që kërkojnë vëmendje urgjente nga komuniteti global i të dhënave. Ndërsa qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm mbulojnë të gjitha fushat e zhvillimit, përfshirë zbutjen e ndryshimit të klimës dhe lëvizjen drejt një ekosistemi më të qëndrueshëm, të dhënat në lidhje me popullatën do të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në vlerësimin e përparimit tonë drejt përmbushjes së objektivave: në listën zyrtare të treguesve madje 97 ose 40 për qind kanë një element të lidhur me popullatën.

ÇFARË ËSHTË REGJISTRIMI?

Regjistrimi i popullsisë, familjeve dhe banesave përcaktohet si një operacion statistikor që zhvillohet në interval të rregullt (zakonisht në dhjetë vjet) për të llogaritur zyrtarisht popullsinë në territorin e vendit – nga njësitë e tij më të vogla gjeografike territoriale

deri në nivelin shtetëror, së bashku me demografinë e përcaktuar dhe karakteristikat sociale dhe ekonomike të popullsisë së përgjithshme. Përkufizimi i dytë më i përdorur është se Regjistrimi është procesi i mbledhjes, përpunimit, vlerësimit, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave për popullsinë, familjet dhe banesat e një shteti (ose territori) brenda një intervali kohe të caktuar.


Zakonisht regjistrimet bëhen çdo 10 vjet, në vite që përfundojnë në 0 ose një. Regjistrimet moderne janë një burim i rëndësishëm statistikor për:

- mbledhjen e të dhënave individuale për popullsinë, familjet dhe banesat nga niveli më i ulët gjeografik në atë shtetëror; dhe
- përfaqësojnë një bazë të rëndësishme për vendimmarrjen dhe menaxhimin modern në të gjitha nivelet;
- Sigurojnë një fond të madh

të statistikave përkatëse të nevojshme për analizën e situatës dhe planifikimin makroekonomik të ardhshëm të zhvillimit të vendit;

- sigurojnë vazhdimësinë dhe krahasueshmërinë me rezultatet e regjistrimeve të mëparshme;
- përfaqësojnë një trashëgimi që duhet ta sigurojmë për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Regjistrimi ose regjistrimet (siç i bëjnë të gjitha vendet) japin një pamje të plotë dhe krijojnë një kornizë për të dhënat e popullsisë së vendit, familjet e tij dhe kushtet e jetesës. Të dhënat e regjistrimit janë të krahasueshme në të gjitha nivelet gjeografike pasi ato mblidhen gjatë një periudhe referimi dhe në një mënyrë të harmonizuar. Përgatitja teknike dhe kryerja e operacionit të regjistrimit është përgjegjësi e zyrave kombëtare të statistikave dhe duhet të mbështetet nga organet e tjera qeveritare.



KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË REGJISTRIMIT: STANDARDET E KB-SË

KARAKTERISTIKAT THELBËSORE TË REGJISTRIMIT TË POPULLATËS DHE STREHIMIT JANË NUMËRIMI INDIVIDUAL, UNIVERSALITETI BRENDA TERRITORIT TË PËRCAKTUAR, ZHVILLOHET NË TË NJËJTËN KOHË, PERIODICITETI I PËRCAKTUAR DHE STATISTIKAT E ZONAVE TË VOGLA.

1 Numërimi individual

Secili individ dhe secili grup habitatesh numërohen veçmas dhe karakteristikat në të regjistrohen veçmas.

2 Universaliteti i një territori të caktuar

Regjistrimi përfshin territorin e përcaktuar saktësisht dhe çdo person që është i pranishëm dhe / ose banon në një territor të caktuar duhet të përfshihet. Shtrirja universale e regjistrimit, domethënë përpjekja për të numëruar të gjithë njerëzit në një zonë të

caktuar gjatë një periudhe kohe të caktuar, gjithashtu nënkupton që regjistrimi është shpesh burimi i vetëm potencialisht i besueshëm i informacionit për popullsitë e pakicave, për ata që rrezikojnë të lihen pas, si p.sh. sigurimi i të dhënave për ngjarje të rralla ose të vështira për t'u matur, të tilla si migrimi dhe vdekshmëria.

3 Në të njëjtën kohë

Çdo person dhe secili grup i habitateve duhet të numërohet në një moment të saktë, dhe të dhënat e mbledhura duhet ti referohen një periudhe referimi të përcaktuar mirë.



4 Perioditeti i përcaktuar

Regjistrimet duhet të merren në intervale të rregullta për të bërë informacion të krahasueshëm në një sekuencë të veçantë. Rekomandohet të bëhet një regjistrim kombëtar çdo 10 vjet¹. Rezultatet e regjistrimit duhet të jenë të krahasueshme ndërkombëtarisht. Prandaj, vendet duhet të bëjnë përpjekje për të kryer një regjistrim në vite që përfundon me "0" ose në të njëjtën kohë sa më afër që të jetë e mundur për ato vite.



5 Kapaciteti për të prodhuar statistika në zona të vogla

Regjistrimi duhet të prodhojë të dhëna për numrin dhe karakteristikat e popullsisë dhe njësive të strehimit në nivelin më të ulët gjeografik, të përshtatshëm me mjedisin kombëtar dhe grupet e vogla të popullsisë, duke mbrojtur konfidencialitetin e informacionit personal për secilin individ.

Kombet e Bashkuara rekomandojnë që popullsia të regjistrohet çdo 10 vjet. Rekomandimet e Kombeve të Bashkuara përfshijnë gjithashtu të dhënat e regjistrimit të

popullsisë, përkufizimet zyrtare, klasifikimet dhe informacione të tjera të dobishme për të koordinuar praktikën ndërkombëtare. Kombet e Bashkuara rekomandojnë që të gjitha vendet ose rajonet e botës të prodhojnë statistika të hollësishme mbi popullsinë dhe strehimin për fusha të vogla të paktën një herë në periudhën 2015-2024, rreth vitit 2020.

Regjistrimet e bëra me anë të një regjistrimi në terren jo domosdoshmërisht ndjekin një model të përbashkët midis vendeve të ndryshme, por ato kanë disa elementë kryesorë të përbashkët. Në

përgjithësi, operacionet e regjistrimit mund të ndahen në disa faza që nuk janë plotësisht të ndryshme në mënyrë kronologjike ose reciprokisht të përjashtuara. Këto janë:

1. përfshirja e palëve të interesuara
2. punë përgatitore (përfshirë legjisacionin, testimin dhe autorsing)
3. numërimi
4. përpunimi i të dhënave
5. sigurimi i cilësisë së të dhënave para shpërndarjes së tyre
6. shpërndarja e rezultateve
7. vlerësimi i mbulimit të të dhënave dhe cilësia e tyre dhe
8. analiza e rezultateve.

1 Të dhënat e regjistrimit të çdo vendi kanë vlerë më të madhe në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar nëse mund të krahasohen me rezultatet e regjistrimeve të vendeve të tjera që u bënë përafërsisht në të njëjtën kohë. Sidoqoftë, është e qartë se aspektet ligjore, administrative, financiare dhe të tjera shpesh e bëjnë të papranueshëm që një vend t'i përmbahet skemës standarde ndërkombëtare në kohën e regjistrimit. Prandaj, kur caktoni datën e regjistrimit, faktorëve të tillë kombëtarë duhet t'i jepen më shumë peshe nga dëshira e njëkohshmërisë ndërkombëtare.



ÇFARË REGJISTRIMI DO TË ZBATOHET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Ekzistojnë tre mënyra për të bërë regjistrimin: regjistrimi tradicional, regjistrimi i bazuar në regjistra, regjistrimi i kombinuar

Regjistrimet tradicionale mund të bëhen në dy mënyra ose metoda të numërimit (në mënyrë alternative); e para është kur regjistruesit mbledhin informacione shtëpiake përmes intervistimit dhe plotësimit të formularëve të regjistrimit; e dyta është kur formularët plotësohen nga anëtarët e familjes (vetëvlerësim) ku formularët u dorëzohen familjeve dhe mbledhen nga regjistruesit ose me postë.

Metodologjia e dytë e regjistrimit është një regjistrim i bazuar në regjistra. Është ndërtuar rreth një grupi të regjistrave themelorë që përbajnë të dhëna gjithëpërfshirëse për njësitë që do të përshkruhen në regjistrimet e popullsisë dhe të strehimit. Regjistrat më të përdorur janë regjistri i popullsisë,

regjistri i ndërtesave dhe banesave, regjistrat e biznesit, regjistrat e sigurimeve shoqërore dhe regjistrat arsimorë.

E treta është regjistrimi i kombinuar (regjistrat dhe mbledhja e të dhënave në terren). Kjo është një metodë e kombinuar metodologjike, ku merren disa informacione nga regjistrat, ndërsa informacionet e tjera mbi ndryshoret e zgjedhura mblidhen përmes operimit në terren. Kjo mund të bëhet duke përdorur formularët e regjistrimit të kompletuar nga të gjitha familjet në një mënyrë të ngjashme me regjistrimin tradicional ose përmes sondazheve ad hoc. Përveç mbledhjes së informacionit për çështje që nuk përfshihen nga regjistrat, të dhënat e mbledhura në operacionet në terren mund të përdoren për të

vlerësuar mbulimin dhe saktësinë e regjistrit. Për këtë arsye, kjo metodë ndonjëherë përdoret për të kaluar nga një regjistrim tradicional në një regjistër të plotë regjistrimi.

Enti i Statistikave Shtetërore njoftoi një regjistrim të kombinuar dhe informoi për aktivitetet e kryera në këtë drejtim¹⁰.

Për këtë janë ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Janë identifikuar burimet e mundshme administrative dhe është vlerësuar fizibiliteti i tyre për sa i përket disponueshmërisë, përmbajtjes dhe cilësisë.
- me qëllim të përcaktimit të burimit, d.m.th. cili institucion është më i përshtatshmi për të dhëna të caktuara, është pajtuar që secili nga institucionet kompetente të sigurojë

të dhëna nga bazat e të dhënave në dispozicion.

- Për të përfunduar këtë aktivitet, si pika fillestare u përdorën marrëveshjet e bëra / memorandumet të bashkëpunimit midis Entit Shtetëror të Statistikës (ETSH) dhe institucionet kompetente.
- Është bërë investigim metodologjik i përmbajtjes së burimeve individuale administrative (struktura e bazës së të dhënave, përshkrimi i variabileve, klasifikimet e përdorura, harmonizimi i koncepteve nga burime të ndryshme).
- Përzgjidhen institucionet, bazat e të dhënave të cilave janë të ndërlidhura dhe formojnë shtyllën kurriore të bazës së të dhënave statistikore të popullsisë.



REGJISTRIMI SI TEMË GAZETARIE

Regjistrimi është statistikor, jo veprim politik. Përkundër asaj që në shoqërinëtonë ekzistojnë një sërë problemesh serioze demografike siç janë: Ulja e niveleve të lindjeve dhe rritjes natyrore, plakja demografike, largimi e popullsisë së re që punon, polarizimi i zhvendosjes hapësinore (përqendrimi më i lartë i popullatës në vendbanimet urbane), dhe shpërngulja e popullatës në disa prej vendbanimeve rurale, etj., media shkruan vetëm për momentin etnik dhe problemet përreth tij.

Shembuj të titujve:

REGJISTRIMI SI FUSHË E GARËS POLITIKE

<http://www.megjutoa.mk/2014/07/>

popisot-kako-pole-na-partiski-natprevar/

REGJISTRIMI AKOMA PA FILLUAR I NDEZI

EPSHET <http://inbox7.mk/archives/5624>

MAQEDONASIT NË SHQIPËRI: Deklarimi i

përkatësisë etnike në regjistrim të jetë i

detyrueshëm <http://ripostmk.com/>

Regjistrimi është një temë tërheqëse,

madje edhe sensacionale. Përmes

shkrimit për regjistrimin, gazetari mund të

përmbushë të gjitha funksionet shoqërore

që ka¹¹: informimi, artikulimi i opinionit

publik, përcaktimi i agjendës, kritika dhe

kontrolli i qeverisë, argëtimi, funksioni

arsimor, integrimi.

- Informacion–duke informuar për regjistrimin (mënyrën e zbatimit, problemet, fazat, mjetet) gazetaria i vë në dispozicion të publikut faktet e regjistrimit dhe ndikon tek opinionin për rëndësinë e vërtetë të këtij procesi

dhe vendimin real që duhe të sjellë çdo individ si konsumator ose subjekt politik.

- Artikulim–media shpërndan situata të caktuara dhe aktualizon probleme. Për shembull, problemi i migracionit të madh mund të aktualizohet përmes mediave.
- Vendosja e axhendës–nga mediat dhe gazetarët varet se në cilat tema dhe ngjarje do të përqendrohet vëmendja e publikut. Shumë shpesh, nga vullneti i gazetarëve varet se cila temë do të aktualizohet, me një tendencë për të lënë në hije ngjarjet e tjera.
- Kritika dhe kontrolli–Gazetarët duhet të kontrollojnë një program të mirë të regjistrimit: si bëhet regjistrimi i popullsisë, nëse kemi trajnuar regjistruet, sa është shpenzuar për regjistrimin, nëse shteti është i gatshëm për një regjistrim të kombinuar, nëse sektori i OJQ-ve



konsultohet në mënyrë adekuate dhe çështje të tjera. Xhozef Pulitzer: Shumë krime, korrupsion dhe imoralitet do të jenë më të vështira nëse ekziston frika nga gazetarët sesa frika ndaj ligjit. “Detyra e gazetarit investigues është të ndriçojë anën e errët të pushtetit dhe të njoftojë të fuqishmit se abuzimi i pushtetit është i rrezikshëm. Ndërhyrje në lëshimet e sundimit të ligjit është veprimtaria dhe hetimi i lirë i gazetarëve, derisa edhe ata vetë nuk bëhen shkelës të ligjit.” (Leyendecker)¹².

- Argëtim – rezultatet e regjistrimit japin imazhin e shumë tendencave interesante dhe argëtuese, për shembull cili emër personal (femër ose mashkull) është më i zakonshmi në shoqërinë tonë dhe kuriozitete të tjera që bëjnë pjesë në argëtim;
- Edukimi – Në shoqërinë moderne, të rinjtë gjithnjë e më shumë po zgjerojnë

njohuritë e tyre përmes mediave. Tema e regjistrimit ofron shumë përmbajtje arsimore.

- Integrimi – tema regjistrimit e polarizon, dezintegron shoqërinë maqedonase. Duke nënvizuar aspektet e tjera shumë të rëndësishme të kësaj baze të të dhënave (ekonomia, fuqia punëtore, shëndetësia, zhvillimi) shoqëria do të integrohet dhe do të debatohet rreth gjërave të dobishme.

PËRKATËSIA ETNIKE SI ÇËSHTJE E REGJISTRIMIT

Treguesit e mbledhur përmes Regjistrimit të popullsisë, familjeve dhe banesave janë paraqitur në “Rekomandimet Ndërkombëtare të KB-së / Eurostat për Zbatimin e Regjistrimit të Popullsisë dhe Strehimit, rreth vitit 2020, dhe janë ndarë në dy grupe: kryesore dhe dytësore. Çdo shtet anëtar i KB, për hir të krahasueshmërisë së të dhënave

ndërkombëtare, është i detyruar të ndjekë këto rekomandime dhe të sigurojë që pikat kryesore të ruhen, por jo më pak e rëndësishme është përparësia e mbledhjes së të dhënave për nevoja kombëtare dhe ato që i duhen shtetit – “Të dimë se çfarë na duhet, duhet të dimë se çfarë kemi” Shembulli më tipik i kësaj janë tiparet e karakteristikave etno-kulturore: përkatësia etnike, gjuha amtare, gjuha që flitet zakonisht në familje dhe përkatësia fetare, të cilat sipas Rekomandimeve janë karakteristika jo të detyruara ose të dorës së dytë, por tek ne prania e kësaj karakteristike (për të siguruar vazhdimësinë me regjistrimin e mëparshëm) dhe nevojës për praninë e kësaj karakteristike me interes kombëtar- ato janë të përfshira në regjistrime. Çështjet që do të shtrohen në regjistrim (ose temat e regjistrimit) ndahen në çështje që janë “thelbësore” dhe çështje që janë “jo thelbësore”. Çështjet që janë “thelbësore”

konsiderohen thelbësore për sigurimin e informacionit kryesor që plotësojnë kërkesat më të larta kombëtare dhe lokale të përdoruesit. Çështje (tema) “jo thelbësore” janë ato, përfshirja e të cilave mund të konsiderohet më pak e rëndësishme. Ato janë opsionale, por në disa vende për shkak të rrethanave të caktuara, disa nga çështjet jo-thelbësore (temat) janë po aq të rëndësishme sa temat kryesore. Sipas Rekomandimeve të KB-së, nevoja për të dhëna nga regjistrimi i një vendi me kalimin e kohës i pasqyron rrethanat, qëndrimet dhe aftësitë në ndryshim, dhe në këtë mënyrë edhe kufirin midis asaj që duhet të konsiderohet “thelbësore” dhe “jo-thelbësore” që disa tema të jenë në gjendje t’i nënshtrohet interpretimit kombëtar. Temat kryesore janë ato që konsiderohen se kanë interes parësor dhe me vlerë për Shtetet Anëtare të CES¹³. Rekomandohet që këto shtete të mbulojnë këto tema në regjistrimet e tyre të popullsisë dhe strehimit

të vitit 2020. Çështjet (temat) jo-thelbësore vendet do të mund t’i përzgjedhin mbi bazën e prioriteteve të tyre kombëtare.

Çështjet detyrueshme për raundin tjetër të regjistrimeve rreth vitit 2020 përfshijnë:

1. Popullsinë në vendbanimin e zakonshëm (përfshirë mungesën e përkohshme, me përjashtim të personave që janë përkohësisht të pranishëm)
2. Vendndodhja gjeografike e banesave dhe vendeve të punës
3. Demografia: gjinia, mosha, gjendja civile, vendi i lindjes, shtetësia, statusi i migracionit, data e mbërritjes së migrantëve
4. Familjet: përbërja dhe lloji i familjes
5. Ekonomia: statusi i aktivitetit, papunësia dhe punësimi, profesioni dhe veprimtaria
6. Edukimi: arritjet dhe avancimet
7. Banesa dhe ndërtesa: lloji, viti i ndërtimit, hapësira, numri i dhomave

8. Pronësia dhe statusi i qiramarrësit
9. Kapacitetet: ujë, ngrohje, tualet, banjë
Përkatësia etnike i përket grupit të çështjeve jo të detyrueshme në regjistrim
Çështjet ndihmëse (temat) shërbejnë për të përshkruar temat kryesore: p.sh. mbi migracionin, punësimin, arsimin, burimet e të ardhurave, mjetet dhe kostot e familjeve, karakteristikat e banesave, etj.
Temat ndihmëse përfshijnë:

1. etnitetin,
2. fenë
3. gjuhën dhe
4. aftësia e kufizuar.

Në Evropë, të dhënat për përkatësinë etnike dhe fenë përfshihen vetëm nga pakica e vendeve. Këto tema janë shpesh të diskutueshme, të ndjeshme dhe jo të përcaktuara mirë. Çështjet gjuhësore janë të zakonshme dhe tipike për vendet ku fliten shumë gjuhë. Çështjet e aftësisë së kufizuar lindin nëse burimet e tjera të të dhënave për këtë nuk janë të disponueshme.


Eurostat nuk publikon të dhëna për përkatësinë etnike ose fenë, kryesisht sepse legjislacionet dhe praktikat nacionale në shumë vende nuk lejojnë mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi etninë ose fenë në statistika. Sipas Eurostat, përkatësia etnike është një çështje e ndërlikuar, dhe madje edhe kur mbledhen statistikat mund të jetë e gabuar të krahasosh të dhënat.

RREGULLATIVA KOMBËTARE

Roli i qeverisë në këtë aktivitet vërehet edhe në rekomandimet e Kombeve të Bashkuara. Ka tre fusha ku qeveria luan një rol në regjistrim. Ajo siguron:

1. korniza ligjore për kryerjen e regjistrimit;
2. financimi i regjistrimit;
3. mbështetje logjistike për regjistrimin.

Për Regjistrimin janë të rëndësishëm dokumentat e mëposhtëm: Ligji për Regjistrimin e Statistikave Shtetërore; Programi i Kërkimit Statistikor 2018 -2022.



PROGRAMI I KËRKIMEVE STATISTIKORE 2018-2022 I ËSHTË PROGRAMI I PESTË PESË-VJEÇAR QË DO TË MIRATOHET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË PAS MIRATIMIT TË LIGJIT PËR STATISTIKAT SHETËRORE.

QËLLIMI I PROGRAMIT ËSHTË TË SIGUROJË NJË SISTEM TË QËNDRUESHËM TË STATISTIKAVE SHETËRORE, BAZUAR NË STANDARDE TË PËRCAKTUARA MIRË KOMBËTARE DHE NDËR-KOMBËTARE, TË CILAT DO TË JENË NË PËRPUTHJE DHE TË KRAHASUESHME ME SISTEMET STATISTIKORE NDËRKOMBËTARE. PROGRAMI ËSHTË I INTEGRUAR PËR TË GJITHË PJESËMARRËSIT E AUTORIZUAR PËR TË PARANDALUAR PRODHIMIN E STATISTIKAVE ZYRTARE JASHTË SISTEMIT TË STATISTIKAVE SHETËRORE.

QËLLIMI I PROGRAMIT ËSHTË TË PRODHOJË NJË SISTEM TË INFORMACIONIT STATISTIKOR ME CILËSI TË LARTË QË DO TË MBËSHTESË ZHVILLIMIN E NJË EKONOMIE TË TREGUT NË VEND, SI BAZË PËR: MARRJEN E VENDIMEVE CILËSORE NË TË GJITHA SFERAT E VEPRIMTARIVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE VEPRIMTARIVE TË TJERA NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, MINISTRITË KOMPETENTE DHE ORGANET E TJERA SHTETËRORE

» marrjen e vendimeve cilësore nga menaxherët e sektorit privat në analizën dhe planifikimin e zhvillimit të biznesit;

» marrjen e vendimeve cilësore nga menaxherët e sektorit publik;

» mbështetjen e kërkimit shkencor si një segment mbështetës të zhvillimit;

» vazhdimësinë e serive kohore.

PROGRAMI GJITHASHTU DO TË SIGUROJË TË DHËNA TË KRAHASUESHME PËR:

- » zhvillimin e vendit dhe për shkak të nevojës për krahasim me vendet e tjera të rajonit, kandidatët për anëtarë dhe anëtarë të Bashkimit Evropian, si bazë për përafrimin e Republikës së Maqedonisë me Bashkimin Evropian;
- » vlerësimin e investitorëve të huaj mbi mundësitë dhe efektivitetin e kostos së investimeve në fushat me interes të tyre në Republikën e Maqedonisë;
- » përafrimi i sistemit statistikor të Republikës së Maqedonisë me sistemin statistikor të Bashkimit Evropian.

PROGRAMI DUHET TË SIGUROJË TË DHËNA ME RËNDËSI RAJONALE PËR:

- » planifikimin e zhvillimit rajonal të vendit;
- » të dhëna se si mund të përdoren fondet strukturore të Bashkimit Evropian dhe kur plotësohen kushtet e tjera në vend.



PROGRAMI DUHET TË SIGUROJË STATISTIKA CILËSORE PËR OPINIONIN E GJERË PËR TË PËRMBUSHUR NEVOJAT E TYRE (TË MEDIAVE, STUDENTËVE, NXËNËSVE DHE TË TJERË)

PLANI STRATEGJIK

Dokumenti themelor që rregullon përparësitë strategjike të Zyrës së Statistikave Shtetërore nga viti 2019 deri në vitin 2021 është Plani Strategjik i Zyrës së Statistikave Shtetërore, 2019–2021.

Realizimi i programeve dhe nën-programeve të përcaktuara duhet të sigurojë:

Përbushjen e detyrimeve të Zyrës Shtetërore të Statistikave siç përcaktohet në Programin e Kërkimit Statistikor, 2018–2022 dhe Realizimin e prioriteteve strategjike të

Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në lidhje me integrimin e Republikës së Maqedonisë në BE, d.m.th. realizimin e detyrimeve të Programit Kombëtar për Miratimin e Legjislacionit Evropian (NPAA). Në përgatitjen e Planit Strategjik, respektohen plotësisht: Ligji për Statistikat Shtetërore dhe Programi pesëvjeçar për Kërkime Statistike, 2018–2022.

Janë marrë parasysh edhe dokumentet përkatëse të Komisionit Evropian që përcaktojnë përparësitë strategjike të

Sistemit Evropian të Statistikave me të cilat monitorohet progresi i Zyrës së Statistikave Shtetërore, si dhe rekomandimet e vlerësimit të partneritetit (Peer Review) të Komisionit Evropian për përparimin në zbatim të Kodeksit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe rekomandimet nga misionet vjetore të rregullta të Eurostat (Zyra e Statistikave të Komisionit Evropian) për të vlerësuar përparimin e institucionit në drejtim të harmonizimit me standardet e BE-së.

Statistikat zyrtare prodhohen në përputhje me parimet e neutralitetit, pavarësisë profesionale, objektivitetit, racionalitetit dhe mbrojtjes së të dhënave individuale.

Qëllimet strategjike dhe vlerat thelbësore përcaktohen në Planin Strategjik 2018-2020 dhe sipas këtij dokumenti vizioni i Zyrës së Statistikave Shtetërore duhet të

njihet si një institucion që ofron statistika cilësore, në kohë dhe ndërkombëtarisht të krahasueshme.





MË 29 JANAR 2014, ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KOMBEVE TË BASHKUARA MIRATOI REZOLUTËN A / 68 / L.36 ME TITULL PARIMET THEMELORE TË STATISTIKAVE ZYRTARE SIÇ U MIRATUAN FILLIMISHT NGA KOMISIONI I STATISTIKAVE 20 VJET MË PARË, NË PRILL 1994.

Parimet u mbështetën nga Komisioni i Statistikave me një parathënie (preambulë) të re në mars të vitit 2013 dhe më pas u miratuan nga Këshilli Ekonomik dhe Social më 24 korrik 2013 (Rezoluta 2013/21). Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Parimet Themelore për herë të parë marrin një njohje kaq të lartë në nivelin politik global.

Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare të Kombeve të Bashkuara (Preambula e Rishikuar 2013) Këshilli Ekonomik dhe Social, duke u mbështetur në rezolutat e fundit të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit Ekonomik dhe Social, duke

theksuar rëndësinë themelore të statistikave zyrtare për zhvillimin kombëtar dhe ndërkombëtar, Duke pasur parasysh rolin kritik të informacionit statistikor me cilësi të lartë për analizën e bazuar në prova dhe vendimarrjen në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm, paqes dhe sigurisë, si edhe shkëmbimin e ndërsjellë të njohurive dhe të tregtisë midis vendeve dhe popujve të botës të cilët janë të lidhur me shpejtësi duke kërkuar hapje dhe transparencë,

Duke pasur parasysh gjithashtu se besimi i nevojshëm i publikut në integritetin e sistemeve zyrtare të statistikave dhe besimi në statistika varet në masë të madhe nga respektimi i vlerave themelore

dhe parimeve themelore të çdo shoqërie që dëshiron të kuptojë veten dhe të respektojë të drejtat e publikut, anëtarët e saj, dhe në këtë kontekst, Për të qenë efektive, vlerat thelbësore dhe parimet që rregullojnë punën statistikore duhet të garantohen nga kornizat ligjore dhe institucionale dhe respektohen në të gjitha nivelet politike dhe nga të gjithë aktorët në sistemet statistikore kombëtare, miratohen Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare të dhëna më poshtë , të miratuar nga Komisioni i Statistikave në 1942 dhe të konfirmuara në 2013, dhe i rekomandon më tej për miratim nga Asambleja e Përgjithshme.





Parimi 1:

Statistikat zyrtare ofrojnë një element të domosdoshëm në sistemin e informacionit të një shoqërie demokratike, duke i siguruar qeverisë, ekonomisë dhe publikut të dhëna për kushtet ekonomike, demografike, sociale dhe mjedisore. Për këtë qëllim, statistikat zyrtare që kalojnë testin e praktikitetit do të përpilohen dhe do të jenë të disponueshme në mënyrë të paanshme nga agjencitë zyrtare të statistikave në favor të së drejtës së qytetarëve për informacion publik.



Parimi 2:

Për të ruajtur besimin në statistikat zyrtare, agjensitë statistikore duhet të vendosin në përputhje me konsideratat rreptësisht profesionale, përfshirë parimet shkencore dhe etikën profesionale, për metodat dhe procedurat për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe paraqitjen e statistikave.

1 Përfshihen Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 64/267 në “Ditën e Statistikave Botërore” dhe Rezolutat e Këshillit Ekonomik dhe Social 2006/6 për forcimin e kapacitetit statistikor

dhe 2005/13 mbi Programin e Regjistrimit të Popullsisë Botërore dhe të Familjeve, 2010. **2** Për preambulën origjinale të përdorur në lidhje me miratimin fillestar të Parimeve në 1994, shiko raportin e Komisionit të Statistikave për seancën e tij të veçantë (E / 1994/29), Kapitulli V, në dispozicion në <http://unstats.un.org/unsd/statcom/94report.pdf>. Më shumë informacion mbi Parimet Themelore dhe historinë e tyre mund të gjenden në <http://unstats.un.org/unsd/dnss/gp/fundprinciples.aspx>.

**Parimi 3:**

Për të lehtësuar interpretimin e saktë të të dhënave, agjencitë statistikore duhet të paraqesin informacione në përputhje me standardet shkencore për burimet, metodat dhe procedurat e statistikave.

**Parimi 4:**

Agjencitë statistikore kanë të drejtë të komentojnë keqinterpretimin dhe keqpërdorimin e statistikave.

**Parimi 5:**

Të dhënat për qëllime statistikore mund të merren nga të gjitha llojet e burimeve, qofshin ato anketime statistikore apo burime administrative. Agjencitë statistikore duhet të zgjedhin burimin duke marrë parasysh cilësinë, kohën e duhur, koston dhe barrën e ofruesve të të dhënave.

**Parimi 6:**

Të dhënat individuale të mbledhura nga agjencitë statistikore për koleksionet statistikore, pavarësisht nëse ato i referohen personave fizikë ose juridikë, duhet të jenë rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore.

**Parimi 7:**

Ligjet, rregulloret dhe masat nën të cilat funksionojnë sistemet statistikore duhet të jenë publike.

**Parimi 8:**

Koordinimi midis agjencive statistikore në vendet është i rëndësishëm për të arritur qëndrueshmëri dhe efikasitet në sistemin statistikor.

**Parimi 9:**

Përdorimi i koncepteve, klasifikimeve dhe metodave ndërkombëtare nga agjencitë statistikore në secilin vend promovon qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve statistikore në të gjitha nivelet zyrtare.

**Parimi 10:**

Bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh në statistika kontribuojnë në përmirësimin e sistemeve zyrtare të statistikave në të gjitha vendet.

AGJENCIA KOMBËTARE STATISTIKE: ENTI SHTETËROR I STATISTIKËS (ESHSH)¹⁴

Enti Shtetëror i Statistikave është bartës dhe koordinatori themelor i sistemit statistikor në vend, ai është institucioni përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e statistikave, si dhe për përcaktimin e metodologjive dhe standardeve statistikore dhe sigurimin e mbrojtjes së të dhënave individuale të mbledhura nga individët dhe nga subjektet juridike.

Një organ ekspert dhe këshillues për statistikat e shtetit është Këshilli i Statistikave. Anëtarët e Këshillit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Enti Shtetëror i Statistikave është vendosur në Shkup dhe punëson 288 persona, 195 në Zyrën Qendrore dhe 93 në 8 njësitë rajonale.¹⁵ Punën e tij ky organ e bazon në:

- Ligjin për statistikë shtetërore;
 - Ligjin për regjistrimin;
 - Kodeksin për punën e statistikës evropiane;
 - Parimet e KB-së;
- Sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara, roli i byrosë kombëtare të statistikave ose agjencisë statistikore përgjegjëse për ndërmarrjen e regjistrimit është të sigurojë një program të suksesshëm të regjistrimit, i cili jep rezultate për përdorim në zhvillim, vlerësim dhe hulumtim dhe vendimmarrje të bazuar në prova. Kështu që, zyrat e statistikave ose agjencitë statistikore përgjegjëse për regjistrimin duhet të kryejnë aktivitetet e mëposhtme:
- Vendosja e legjislacionit statistikor që detyron ndërmarrjen e regjistrimit;
 - Vendosja e politikës dhe strategjisë duke përcaktuar target rezultatet dhe

- rezultatet e programit;
- Angazhimi strategjik me palët e interesuara duke mobilizuar qeverinë, biznesin dhe pjesëmarrjen e publikut në tërësi;
- Rritja e profilit dhe angazhimi për përdorimin e informacionit statistikor; të sigurojë mundësi për t'u përfshirë në çështjet kryesore të politikave dhe forcimin e marrëdhënieve midis ofruesve të informacionit, krijuesve të politikave dhe liderëve të opinionit publik.
